

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 13 TETOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, ne e organizojmë këtë debat për të transmetuar problemet që ka zona dhe është vërtet skandaloze kur kthehesh e shikon se ministret ose kanë shkuar për të bërë ndonjë qokë, ose kanë shkuar për ndonjë drekë të këndshme. Kjo është e patolerueshme; është vërtet skandaloze. Kjo u ka hequr vullnetin kolegëve të mi që ta shfrytëzojnë këtë moment për të sjellë në vëmendje të ministrave problemet e zonës. Në fakt, ministrat nuk i gjen as në terren, madje nuk gjejnë as kohë për të qenë një orë të vetme në katër javë apo edhe në tri ndonjëherë të bëjmë debat.

Mua më shqetësojnë shumë probleme në qarkun e Dibrës, por një problem shqetësues është arsimiti (marr shkas edhe nga statistikat e bëra në 10 vjetët e fundit), sepse numri i nxënësve është ulur me 38%. Para 15 vjetëve numri i nxënësve në klasën e parë kanë qenë 77 mijë, ndërkohë që këtë vit është 29 mijë, pra vetëm 37% e atyre që ishin 15 vjet më parë. Në fakt, kjo është shumë shqetësuese. Duke marrë shkas nga kjo, unë bëra një tur takimesh në zonën ku jam deputet dhe pashë nga afër jo vetëm gjendjen e shkollave, por edhe standardet e mësuesve në këtë zonë. Nuk di se cilin nga këto probleme të trajtoj më parë, por po përqendrohem te numri i mësuesve.

Në fakt, numri i mësuesve nuk ka ndryshuar, por për të njëjtin numër mësuesish kemi më pak nxënës, por kjo gjë nuk është konvertuar në më shumë cilësi. Në raport me totalin, është ulur numri i nxënësve ekselentë. Vitet e fundit edhe mesatarja e nxënësve po pëson një rënie. Në fakt, kjo ka një arsye. Në takimet me disa mësues për herë të parë zbulova që, të paktën për qarkun e Dibrës, më shumë se sa 70% e mësuesve janë me kontratë. Kjo është skandaloze; kjo është kriminale; kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë te cilësia e arsimit. Në fakt, kjo është

bërë në mënyrë hileqare, sepse një mësues me kontratë nuk paguhet gjatë muajve të verës. Është e papranueshme.

Si mundet një mësues, që nuk i lidhin kontratën, të punojë 7-8 muaj dhe gjatë muajve të verës të detyrohet të ikë emigrant, pastaj të rikthehet? Ky është një shqetësim i jashtëzakonshëm, por nuk mbaron vetëm këtu. Në disa nga shkollat ku shkova, më shumë se 70% e mësuesve ishin me kontratë dhe nuk ishte dita e parë e tyre në arsim. Ata ishin me vjetërsi 30 vjet, 25 vjet, me master dhe me kualifikime maksimale, por partia ka vendosur që ata të mos kenë kontratë për të kursyer buxhetin e shtetit, por edhe për të bërë selektime politike, madje luhet pingpong të drejtori i shkollës, te drejtori i zyrës arsimore të rrethit, te drejtorja rajonale, duke i sorollatur ata. Në fakt, detyrohen të paguajnë.

Madje, kalojnë edhe në filtër politik, filtër financiar, por në fund nxënësit mbeten pa mësues. Është e papranueshme, është skandaloze, por nuk është vetëm kjo. Në qarkun e Dibrës në këta 10 vjetët e fundit janë mbyllur më shumë se sa 50% e shkollave. Kjo ka nxitur në mënyrë të drejtpërdrejtë braktisjen e shkollës. Është një numër rekord fëmijësh, të cilët e kanë braktisur shkollën, sepse shkolla është me kilometra larg dhe nuk shkojnë dot. Nuk mund të shkojnë te shkolla, sepse nuk ka rrugë për të shkuar te shkolla. Nuk mund të shkojnë te shkolla, sepse nuk paguhet furgoni për të shkuar në shkollë. Nuk mund të shkojnë te shkolla, sepse shkollat janë në një situatë skandaloze, ta papranueshme dhe është për të vendosur duart në kokë.

Unë e kuptoj që ndoshta ministrja tani mund të ketë shkuar për t'i vendosur ndonjë shkolle emrin e ndonjë prej ministrave, sepse erdhi në Dibër, por nuk bëri asnjë vizitë në shkollat e Dibrës për të parë situatën kritike të këtyre shkollave, por erdhi e vendosi te një nga shkollat emrin e dajës së dajës të ministres së Infrastrukturës. Në fakt, shkollat me standarde që tha në interpelancë pak më parë, janë këto janë... Këto janë shkollat me standarde të Dibrës?! Si mundet një shkollë në vitin 2023 të ketë këtë pamje?! Si mundet? Ja ky është standardi i shkollave! Ja edhe shkolla të tjera, të cilat janë vërtet në një situatë kaotike. Edhe një herë dua t'u them: thirrni mendjes!

E keni bërë arsimin të padëshiruar; të padëshiruar, sepse keni vendosur notën mesatare dhe një nxënës, që nuk shkon në arsimin e lartë, i cili ka mesataren 6,5, shkon në emigrim dhe e

deligjitimon edhe atë që është në arsimin e lartë, sepse ai pas një viti, pas dy vjetësh vjen me një makinë, kur, në fakt, ky, që ka mbaruar shkollën e lartë e masterin, madje shkëlqyer, nuk ka mundësi të përballojë as edhe qiranë. Besoj se ka edhe shumë instrumente të tjera, por nuk mundem t'i them për shkak të kohës, sepse në këto 60 minuta nuk na jepni 10 minuta, por i cungoni në 5 minuta. Kjo është e papranueshme.

Uroj e shpresoj që arsimi të jetë në fokus, të paktën për qarkun e Dibrës! Më duket se ai qark nuk futet në hartën e Shqipërisë dhe kjo është vërtet e patolerushme. Uroj që "Rilindja" ta futë në hartën e normalitetit edhe këtë qark! Faleminderit!